



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government

Për:	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës Anton Shala, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gjakovës	
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MPL Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Goran Rakić, Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MPL-së Trim Berisha, Zv Sekretar i Përgjithshëm në MPL	
Nga:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 19.02.2021 Nr.020-73
Zyrtaret përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Gjakovës	
Lloji i aktit:	☐ Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 06/2020 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim i Kuvendit të Komunës 01 Nr. 011/01-2741 për miratimin e strategjisë komunale për Komunikim
I miratuar më datë: 28.01.2021
I parashtruar për shqyrtim në MPL më datë: 02.02.2021

Ministria e Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi. Ministria e Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government

Za:	Ardian Gjini , gradonačelnik opštine Đakovica Anton Shala , predsedavajući Skupštine opštine Đakovica
Cc:	Jedinici za administraciju dokumenata u MLS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini
Preko:	Goran Rakić , zamenik premijera i ministar MLS-a Trim Berisha , zamenik generalnog sekretara MLS-a
Od:	Venera Çerkini , direktorka Pravnog odeljenja i monitorisanje opština -MLS Datum, 19.02.2021 Br. 020-73
Službenik za utvrđivanje pravne procene:	Xhevat Tafa , rukovodilac Odseka za monitorisanje opština
Službenik-ca za izradu pravne procene:	Vjosa Ahmetaj , viša službenica za monitorisanje opština
Predmet:	Potvrda zakonitosti odluke Skupštine opštine Đakovica
Vrsta odluke:	Odluka Skupštine opštine

Uvaženi gradonačelnice,

Uvaženi predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 06/2020 o oblastima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Pravno odeljenje i monitorisanje opština MLS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka Skupštine opštine 01 br .011/01-2741 o odobravanju opštinske strategije za komunikaciju
Usvojena dana, 28.01.2021. godine,
Predložena na razmatranje u MLS-u dana, 02.02.2021. godine,

Ministarstvo lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine,

procenjuje da je opštinski akt u proceduralnom aspektu u saglasnosti sa zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi.

Ministarstvo lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.

REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA /
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kuvendi i Komunës - Gjakovë

01 Nr. /2021

Dt. 28.01.2021

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministristvo Lokalne Samouprave i Administracije Ministry of Local Government Administration		
Data 02.02.2021		
Qëllimi/Intencioni	Shënim	Shënim
~VL- 020-73		

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të njeut 12.1 dhe 12.2 të Statutit të 11.06.2011 (Vendimet e Kuvendit të Gjakovës nr 13/1-010, RGZ e RL nr 28/2008), në mbledhjen e mbajtur më datë 28.01.2021 pas diskutimeve bënim me pikën e 8 të rendit të ditës, Shqyrtim i Strategjisë Komunale për Komunikim në Komunën e Gjakovës për periudhën 2021-2023, e miratim këtë:

V E N D I M


Për

miratimin e Strategjisë Komunale për Komunikim

1. Miratohet Strategjia Komunale për Komunikim në Komunën e Gjakovës për periudhën 2021-2023.
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është dokumenti i Strategjisë Komunale për Komunikim në Komunën e Gjakovës për periudhën 2021-2023.
3. Ky vendim hyr në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.
4. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës, z. Ardit Gjini
 - Manastir ... të Administrimit të Pushtetit Lokal
 - Zyres për Informim të Komunës së Gjakovës
 - Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës
 - Arkivat

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

z. Anton Shala



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA /
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës - Gjakovë

01 Nr. _____ /2021

Dt. 28.01.2021


Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12.1 dhe 12.2 shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (GZ e RK nr.28/2008), në mbledhjen e mbajtur me dt. 28.01.2021 pas diskutimeve lidhur me pikën e 8 të rendit të ditës, Shqyrtimi i Strategjisë Komunale për Komunikim në Komunën e Gjakovës për periudhën 2021-2023, e miraton këtë:

V E N D I M

Për

miratimin e Strategjisë Komunale për Komunikim

1. Miratohet Strategjia Komunale për Komunikim në Komunën e Gjakovës për periudhën 2021-2023.
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është dokumenti i Strategjisë Komunale për Komunikim në Komunën e Gjakovës për periudhën 2021-2023.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.
4. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetari i Komunës së Gjakovës, z. Ardian Gjini,
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal,
 - Zyrës për Informim të Komunës së Gjakovës
 - Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës
 - Arkivit

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Z. Anton Shala

2021

STRATEGJIA KOMUNALE PËR KOMUNIKIM 2021-2023

**STRATEGJI E INTEGRUAR E KOMUNIKIMIT TË
BRENDSHËM DHE TË JASHTËM NË
ADMINISTRATËN KOMUNALE**



KOMUNA E GJAKOVËS
Qendër Kulturor dhe Historik

PËRMBAJTJA

HYRJE	3
SFONDI	3
Profili i komunës	3
Misioni dhe Vizioni	4
Struktura e administratës komunale	4
PJESA E PARË: STRATEGJIA PËR KOMUNIKIM TË BRENDSHËM	6
1. KOMUNIKIMI I BRENDSHËM	7
1.1. Qasja për komunikimin e brendshëm	7
1.2. Audiencat e brendshme	8
2. OBJEKTIVAT DHE REZULTATET E PRITURA	9
3. MESAZHET KYÇE	9
4. MEKANIZMI I KOMUNIKIMIT NË TË ARDHMEN	10
5. PLANI VJETOR I KOMUNIKIMIT TË BRENDSHËM	11
6. VLERËSIMI I PERFORMANCËS	11
PJESA E DYTË: STRATEGJIA PËR KOMUNIKIM TË JASHTËM	12
1. HYRJE	13
2. QASJA	13
3. GJENDJA AKTUALE	14
4. OBJEKTIVAT	15
5. PLATFORMA PËR KOMUNIKIM TË JASHTËM	17
6. KANALET E KOMUNIKIMIT	18
7. AUDIENCAT, MESAZHET DHE IMPAKTI I DËSHIRUAR	19
8. PLANI VJETOR PËR KOMUNIKIM TË JASHTËM	24
9. VLERËSIMI I PLANIT TË KOMUNIKIMIT TË JASHTËM	24
10. INDIKATORËT E IMPAKTIT TË KOMUNIKIMIT TË JASHTËM	24

11. RËLLET DHE PËRGJEGJËSITË KYÇE.....	25
12. BUXHETI.....	27
13. SHTOJCAT.....	28
Shtojca 1. Plani i veprimt për komunikim të brendshëm.....	28
Shtojca 2. Plani vjetor për komunikim të jashtëm.....	32
Shtojca 3. Plani i Transparencës 2021-2024.....	38

HYRJE

Qëllimi i kësaj strategjie të komunikimit është që të sigurojë një kornizë për avancimin e praktikave dhe kapaciteteve komunikuese të Komunës së Gjakovës. Kjo do të arrihet përmes thellimit të praktikave të komunikimit me audiencat e brendshme dhe të jashtme duke përdorur kanale të pershtatshme dhe efikase të komunikimit.

Përmes këtij dokumenti do të kërkohej një reagim më pozitiv i audiencave ndaj aktiviteteve dhe projekteve të komunës, e për rrjedhojë edhe fuqizim të marrëdhënieve dhe ndërveprimit me qytetarë, media, organizata të shoqërisë civile, hisedarë dhe partnerë që mbështesin në vazhdimësi nismat e komunës.

Një strategji efikase e komunikimit mbështetet fort në kontributin dhe rolin aktiv të të gjithë të punësuarve në administratën dhe institucionet komunale. Për këtë arsye, pjesë integrale e kësaj strategjie është komunikimi i brendshëm, si një komponentë që ekskluzivisht përqendrohet në përmirësimin e praktikave të komunikimit dhe rritjen e motivimit të të punësuarve në përmirësimin e performancës individuale, ekipore dhe organizative. Bashkëpunimi, bashkërendimi dhe komunikimi efikas (si brenda drejtorive të caktuara ashtu edhe ndërmjet tyre) si dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve dhe marrëdhënieve në punë përbëjnë parakushtet themelore për rritjen e motivimit dhe performancës në punë.

Së fundmi, përmes kësaj strategjie Komuna synon që të rrisë kapacitetet e veta komunikuese, të cilat do të na shërbejnë në rritjen e mirëbesimit me qytetarët dhe kultivimin e marrëdhënieve të shëndosha me të gjitha audiencat e synuara.

Të gjitha këto do ta bëjnë komunën një organizatë më kohezive në raport me komunikimet dhe ndërveprimet dhe më të aftë për t'i shërbyer qytetareve.

Hartimi i Strategjisë Komunale për Komunikim 2021-2023 është realizuar me mbështetjen teknike dhe profesionale të USAID përmes projektit Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (Transparent, Effective and Accountable Municipalities)

SFONDI

Profili i komunës

Komuna e Gjakovës shtrihet në pjesën jugperëndimore të Kosovës në një sipërfaqe prej 586 km² në një lartësi mbidetare prej 365 metrash. Popullsia rezidente e komunës llogaritet të jetë rreth 90.000 banorë. Komuna e Gjakovës kufizohet me Republikën e Shqipërisë, me të cilën ka dy pika kufitare - atë të Qafës së Prushit në jug ku lidhet me Regionin e Hasit (Letaj, Krumë, Kukës, etj.) dhe atë të Qafës së Morinës në perëndim që lidhë Malësinë e Gjakovës (Tropojë, Bajram Curr, etj.).

Qyteti i Gjakovës është i njohur si qendër e rëndësishme kulturore me një fond të pasur të trashëgimisë kulturore dhe historike si: Çarshia e Madhe, Lapidari i Lidhjes së Prizrenit, Varri i Maxharr Pashës, Xhamia e Hadumit (Mejtepi, Biblioteka, Varrezat, Shatërvani), Kulla e Abdullah Pashë Drenit, Muzeu Etnografik, Kulla e Hysni Koshit, Kulla e Sylejman Vokshit, Ura e Tabakeve, Ura e Taliqit, Ura e Terzive, Kompleksi i Sukës së Cërmjanit, Teqeja e Sheh Danjollit, Teqeja e Sheh

Eminit, Shtëpia e Selim Bakljës, Xhamia e Hasan Agës (Rugovë), Xhamia e Fshatit Smolicë, gërmadhat e objektit në vendin e quajtur "Kisha katolike" (shek.II-IV) etj.

Gjakova është e njohur për traditë pune në industri dhe bujqësi si dhe për punonjës të zellshëm në zeytari, tregti dhe shërbime. Ka një strukturë të re të popullsisë dhe me vullnet të spikatur e të përkushtuar në punë. Të gjitha këto përfaqësojnë potencial të madh për të ardhmen. Bizneset e vogla dhe mikro-ndërmarrjet sot dominojnë në ekonominë e Gjakovës. Biznesi privat është në ekspansion dhe treguesit e cilësojnë si strukturën kryesore përbërëse të ekonomisë së Gjakovës. Gjakova ka potencial, traditë prodhuese dhe menaxhuese në sektorët e industrisë metalike, industrisë së tekstilit, industrisë kimike, industrisë ushqimore, industrisë së materialit ndërtimorë, industrisë së drurit, teknologjisë informative, turizmit kulturor dhe agroturizmit.

Misioni dhe Vizioni

Vizioni i Gjakovës është që të jetë një komunë me mundësi të barabarta zhvillimi për të gjithë qytetarët e saj dhe trajtim të prioriteteve në të gjitha fushat e zhvillimit komunal.

Misioni i komunës është që të përshpejtojë ritmet e zhvillimit ekonomik, shtimin e mundësive për shkollim, përkujdesje të vazhdueshme për shëndetin, kulturën rininë dhe sportin, lëmin e bujqësisë si dhe zhvillimin e qëndrueshëm të mjedisit dhe infrastrukturës komunale, partneriteti publiko-privat si çështje më kryesore që mund të ndikojnë për përmirësimin e shpejtë të gjendjes ekonomike e shoqërore të banorëve të komunës.

Struktura e administratës komunale

Synimi i Komunës së Gjakovës është që të krijojë qeverisje lokale efikase, të qëndrueshme dhe demokratike përmes përpjekjeve të përbashkëta të institucioneve komunale. Administrata komunale është e organizuar në 10 drejtori: *Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Kadastrit, Drejtoria e Inspektionit, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Kulturës, Drejtoria e Mbrojtjes dhe Shpëtimit, dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Urbanizmit dhe Drejtoria e Bujqësisë.*

Në kuadër të administratës, më saktësisht në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës, funksionojnë sektore dhe njësi më të vogla organizative, si: *Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerezore, Njësia e Prokurimit, Njësia e Auditimit të Brendshëm, Sektori Ligjor, Sektori për Komunitete dhe Kthim, Sektori për Raportim, Informim dhe Bashkëpunim, Sektori për Integritet Evropian, dhe Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore.*

Zyra për Informim Publik

Zyra komunale për informim publik operon në kuadër të Sektorit për Raportim, Informim dhe Bashkëpunim dhe në përbërjen e vet ka katër (4) zyrtarë: dy (2) zyrtarë për marrëdhënie me publikun, dy (2) zyrtarë për informim, dhe një (1) zyrtar për qasje në dokumente zyrtare.

Zyra për Informim Publik (ZIP) kujdeset për transparencën e qeverisjes kundrejt publikut dhe siguron pasqyrimin e drejtë dhe të saktë të ngjarjeve dhe aktiviteteve të Kryetarit të Komunës, Kuvendit Komunal, drejtorive dhe njësive tjera të ekzekutivit.

Në kuadër të funksioneve të saj, Zyra për Informim Publik koordinon konceptimin, organizimin dhe zbatimin e fushatave me karakter informues apo të ndërgjegjësimi. Zyra mban kontakte të rregullta me përfaqësuesit e mediave, koordinon aktivitetet mediale të përfaqësuesve të komunës, ndërmjetëson në caktimin e intervistave të udhëheqësve komunalë për shtypin, monitoron mediat dhe informon kryetarin dhe drejtuesit e tjerë në lidhje me përmbajtjen e tyre. Më tej, Zyra për Informim Publik mirëmban webfaqen e Komunës, duke publikuar të gjitha njoftimet për mbledhjet, informatat nga takimet e Kryetarit të Komunës, Kuvendit të Komunës dhe trupave të tij, planet dhe raportet e Kuvendit të Komunës dhe trupave të tij, si dhe koordinon publikimin e shpalljeve, konkurseve dhe tenderëve si dhe të gjitha informatat dhe publikimet tjera me rëndësi për qytetarët dhe opinionin e gjerë.

PJESA E PARË: STRATEGJIA PËR KOMUNIKIM TË BRENDSHËM

1. KOMUNIKIMI I BRENDSHËM

Një sistem i mirë i komunikimit të brendshëm mundëson qarkullimin e informacioneve dhe mesazheve në shumë drejtime. Komuna e Gjakovës e një vlerën e shtuar të zyrtarëve të informuar, të interesuar dhe të zotuar për arritjen e qëllimeve strategjike të Komunës, prandaj në mënyrë aktive do të kërkojë kontributin e të punësuarve brenda administratës komunale në rritjen e cilësisë së komunikimeve dhe performancës në ofrimin e shërbimeve. Po ashtu, Komuna do të ndërtojë të gjitha veprimet e duhura për të ndërtuar një kulturë ku të punësuarit në administratën komunale ndjehen rehat dhe kanë besimin e mjaftueshëm për të përdorur të gjitha kanalet e komunikimit për të shprehur mendimet e tyre.

Ky seksion i Strategjisë së komunikimit ka për qëllim që të përcaktojë nevojat dhe kërkesat e komunikimit brendapërbrenda administratës komunale, sistemin dhe përgjegjësitë me qëllim të lehtësimit të *qarkullimit të informacionit, motivimit të personelit dhe avancimit të kushteve të punës*, e për rrjedhojë edhe përmirësimin e performancës së përgjithshme në ngritjen e imazhit dhe reputacionit të organizatës.

Synimi i planifikimit të komunikimit të brendshëm është që të mundësojë qasje të mjaftueshme të personelit në informacionet e duhura për kryerjen e detyrave të ditëpërditshme dhe porosi e udhëzime nga menaxhmenti dhe eprorët (*komunikim nga lart-poshtë*), shkëmbime ndërsektoriale (*komunikim i tërthortë*) dhe do të promovojë një kulturë organizative që promovon dëgjimin e zërit të secilit (*nga poshtë-lart*). Kornizat e komunikimit të brendshëm të përcaktuara në kuadër të kësaj strategjie do të shërbejnë si udhëzues për administrimin e komunikimeve dhe do të azhurnohen sipas nevojave dhe në përputhje me vizionin dhe objektivat strategjike të administratës komunale.

1.1. Qasja për komunikimin e brendshëm

Komuna e Gjakovës mbetet e përkushtuar që të kultivojë një kulturë të qarkullimit të lirë të informacionit brenda administratës komunale, e cila do të stimulonte një përfshirje më të gjerë në procesin e vendimmarrjes së brendshme.

Udhëheqja e komunës do të angazhohet që komunikimi brenda administratës komunale të jetë **i saktë, konsistent, i qartë, i kohshëm dhe i disponueshëm** (i qasshëm) për të gjithë të punësuarit. Komuna është e orientuar drejt një klime bashkëpunuese, sidomos në fazat e planifikimit dhe vendimmarrjes, duke mundësuar një shumësi mundësish dhe kanalesh përmes të cilëve të gjithë zyrtarët komunal do të kenë mundësinë të shprehin mendimet dhe opsionet e tyre për mbarrëvajtjen e punëve në administratë dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve komunale.

Të gjitha veprimet për komunikim të jashtëm dhe marrëdhënie me media (fushatat vetëdijesuese, dëgjimet buxhetore, dëgjimet publike, takimet konsultative me qytetarë, hartimi dhe vlerësimi i planit të transparencës, etj.) do të paraprihen nga një koordinim përfshirës brendapërbrenda administratës.

Së këndejmi:

- Komuna njeh vlerën e shtuar e personelit të informuar, të interesuar dhe të përkushtuar dhe duke u nisur nga kjo premise, do të bëjë të gjitha përpjekjet që të vendosë një sistem komunikimi që mundëson qarkullimin e lirë të ideve dhe nismave.
- Informacioni brenda administratës komunale do të qarkullojë në shumë drejtime: nga menaxhmenti i lartë tek të punësuarit (*lart-poshtë*), shkëmbyrje midis drejtorive dhe sektorëve (*i tërthorë*) dhe promovimi i një kulture organizative ku të gjithë të punësuarit kanë mundësinë të shprehin mendimet dhe idetë e tyre (*poshtë-lart*). Pra, drejtuesit e komunës në mënyrë aktive do të mirëpresin pikëpamjet e të punësuarve duke i siguruar se mendimet e tyre kanë vlerë dhe merren në shqyrtim.
- Mekanizmi i komunikimit brenda administratës komunale do të ndërtohet në atë mënyrë që ta bëjë sa më të lehtë që të jetë e mundur për secilin të punësuar që të kontribuojë në zhvillimin e ideve kreative.

1.2. Audiencat e brendshme

Punonjësit e administratës komunale – Komunikimi me punonjësit e administratës kërkon një intensitet më të madh në mënyrë që të gjithë të jenë të informuar në mënyrë të kohshme me zhvillimet, sidomos në rastet kur ato ndikojnë drejtpërdrejtë në efikasitetin e kryerjes së punëve të tyre të ditëpërditshme.

Kuvendi i Komunës – Detyra parësore e të zgjedhurve në kuvend është që të përcaktojnë dhe jetësojnë kornizën ligjore të funksionimit të komunës (*funksioni ligjvënës*), të zgjedhë organet drejtuese ndërmarrjeve dhe institucioneve komunale (*funksioni zgjedhës*), të kontrollojë punën e organet ekzekutive (*funksioni kontrollues*), dhe të përfaqësojë mendimin dhe interesat e qytetarëve (*funksioni artikullues*). Kabineti i Kryetarit të Komunës dhe administrata komunale do të kenë një komunikim efikas me Kuvendin e Komunës me qëllim të bashkërenditjes së përpjekjeve të përbashkëta për një qeverisje të mirë dhe shërbime cilësore.

Kabineti i Kryetarit të Komunës – Duke pasur parasysh peshën dhe rolin e Kryetarit të Komunës në komunikim, është e pashmangshme që të krijohet një mekanizëm solid përbrenda kabinetit në mënyrë që të administrojë me rrjedhën e komunikimeve. Kabineti i Kryetarit të Komunës do të ketë mbikëqyrje të plotë mbi rrjedhën e komunikimeve, do të vlerësojë efikasitetin e tyre dhe të intervenojë në mënjanimin e mangësive që shfaqen në rrugë e siper.

Drejtuesit e lartë (drejtorët e drejtorive dhe shefat e sektorëve) – ky është një grupim që kërkon një komunikim intensiv, qoftë të planifikuar apo të çastit. Drejtuesit e lartë duhet të kenë në dispozicion informacionet e duhura në një kohë shumë të shkurtër edhe për faktin se janë persona të autorizuar të komunikojnë me audiencat e jashtme. Ata duhet të jenë në kontakt të shpeshtë me vartësit e tyre.

Institucionet komunale (institucionet e arsimit parashkollor dhe parauniversitar, institucionet e shëndetësisë primare dhe sekondare, policia, prokuroria dhe gjykatat, etj.) – mund të

konsiderohen si audiencë e brendshme përkundër pavarësisë vepruese që ua mundëson statusi i tyre juridik. Gjithsesi, komuna do të ketë një komunikim të vazhdueshëm në formatet e dakorduara paraprakisht.

Institucionet dhe agjencitë e specializuara shtetërore (ministritë relevante të linjës, agjencitë e pavarura shtetërore, institucionet komunale dhe rajonale, etj.) janë audiencë që kërkojnë një trajtim të klasifikuar për shkak se ndërlidhen shumë me kompetencat dhe fushëveprimtarinë e komunës. Komunikimi me audiencë të tilla në të shumtën e rasteve është i natyrave këshilluese me synim parësor që të evitohen mospërputhjet, veprimet joligjore apo shkeljet procedurale, e për rrjedhojë edhe rritjen e efikasitetit në punë përmes një qasje më proaktive.

2. OBJEKTIVAT DHE REZULTATET E PRITURA

Kjo strategji për komunikim të brendshëm është e dizajnuara që të mbështetë objektivat madhor të Komunës së Gjakovës për ndryshimin e kulturës organizative dhe rritjen e performancës në ofrimin e shërbimeve. Komuna e Gjakovës aspiron që të ketë personel të mirëformuar, të respektuar e të përkushtuar dhe të bëhet një organizatë e aftë që të menaxhojë me ndryshimet e tashmes dhe të së ardhmes.

Realizimi i kësaj ambicie kërkon një mekanizëm solid dhe mesazhe të fuqishme në kuadër të komunikimit të brendshëm, të cilat në mënyrë të qartë promovojnë mesazhet e Komunës, inkurajojnë punën ekipore dhe mbështesin idetë inovative.

Së këndejmi, objektivat parësorë të Strategjisë për Komunikim të Brendshëm janë:

1. Diversifikimi i formave të komunikimit brenda administratës dhe rritja e angazhimit ndaj synimeve dhe objektivave strategjik të komunës të komunës.
2. Rritja e motivimit dhe performancës të të punësuarve në administratë.
3. Përmirësimi i strukturës dhe mekanizmit komunikues në komunë.

Realizimi efikas i këtyre objektivave do t'ia mundësojë Komunës të arrijë rezultatet si në vijim:

- Arritja e një komunikimi efikas brendapërbrenda administratës komunale dhe me eksponentët e audiencave të brendshme
- Rritja e motivimit dhe vetëvlerësimit të personelit
- Përmirësimi i ambientit dhe kushteve të punës
- Përmirësimi i produktivitetit dhe performancës
- Rritja e përkushtimit për arritjen e synimeve të organizatës

3. MESAZHET KYÇE

Qartësia dhe konsistenca e mesazheve janë një pjesë e rëndësishme e në komunikimet e ditëpërditshme me audiencat e brendshme. Mesazhet kyçe të renditura më poshtë janë hartuar

në funksion të arritjes së objektivave të komunikimit të brendshëm. Ato do të përbëjnë shtyllat qendrore të anës përmbajtëse të komunikimeve me të punësuarit në administratën komunale dhe me audiencat e tjera të brendshme.

- *Administrata komunale bën gjithçka që është e mundur që të jetë një ambient ku të punësuarit mbahen të informuar, degjohen dhe mendimet e tyre respektohen;*
- *Administrata komunale është një ambient ku të punësuarit nxiten dhe inkurajohen të provojnë që gjërat t'i bëjnë më ndryshe dhe më mire;*
- *Administrata komunale aspiron të jetë një ambient ku njerëzit punojnë si një ekip me qëllim të zgjidhjes së problemeve dhe jo vetëm konstatimit të tyre;*
- *Administrata komunale është një ambient ku meritoret vlerësohen dhe shpërblehen;*
- *Administrata komunale është një ambient ku secilit i jepet mundësia për të zhvilluar kapacitetet teknike dhe profesionale dhe avancim në karrierë;*

4. MEKANIZMI I KOMUNIKIMIT NË TË ARDHMEN

Është me rëndësi që Komuna në të ardhmen të komunikojmë përmes mjeteve dhe kanaleve që sigurojnë transmetimin e saktë dhe të kohshëm të informacioneve të të gjithë të punësuarit në mënyrë efikase dhe me kosto të arsyeshme. Kabineti i Kryetarit të Komunës me mbështetjen e Zyra Komunale për Informim do të mirëmbajnë një sistem efikas për përcjelljen e mesazheve tek të gjitha audiencat, duke përdorur, por pa u kufizuar të, format e renditura në vijim:

- Raportimet profesionale dhe të strukturuar që shërbejnë për një administrim dhe monitorim më efikas të aktiviteteve dhe nismave të ekzekutivit.
- Takimet e rregullta formale të Bordit të Drejtorëve
- Takimet e rregullta brenda drejtorive, sektorëve dhe ekupeve
- Informimin e rregullt dhe të strukturuar të të punësuarve mbi ngjarjet dhe zhvillimet që ndërlidhen me administratën komunale dhe Kuvendin e Komunës.
- Rishikimin e praktikave të vlerësimit të performancës së personelit dhe vendosjen e një sistemi shpërblimesh për performancat përtej pritjeve.
- Komunikimin e bashkërenduar dhe efikas i kabinetit të Kryetarit dhe Kuvendit të Komunës;
- Organizimin e takimeve të përgjithshme me personelin e administratës komunale për të diskutuar çështje që ndërlidhen me organizimin dhe funksionimin e punës së administratës (aspektet e administratës, burimeve njerëzore, financave; logjistikës, zhvillimit të kapaciteteve profesionale, etj.);
- Organizimin e Konferencave Vjetore të Kryetarit të Komunës me drejtuesit e lartë të komunës me qëllim të vlerësimit të arritjeve, sfidave dhe rishikimit të politikave dhe nismave strategjike;
- Organizimin e ngjarjeve të fundvitit me të punësuarit në administratën komunale për t'i falënderuar (dhe shpërblyer) për kontributin, si dhe për t'i informuar mbi objektivat dhe planet e qeverisë komunale për vitin në vijim;

- Organizimin e prezantimeve induktive (përshpejtimin e ambientimit) për të sapo punësuarit në administratën komunale;
- Promovimin e punës në ekipe ndër-sektoriale;
- Zbatimin efikas të programit të trajnimeve në funksion të ngritjes teknike dhe profesionale të të punësuarve.

5. PLANI VJETOR I KOMUNIKIMIT TË BRENDSHËM

Me qëllim të arritjes së qëllimit dhe objektivave strategjik të komunikimit, plani i veprimit për komunikim të brendshëm do të zhvillohet mbi baza të vitit kalendarik përgjatë periudhës që mbulon kjo strategji.

6. VLERËSIMI I PERFORMANCËS

Realizimi dhe vlerësimi i këtij plani do të mbikëqyret nga Kryetari i Komunës apo nga zyrtari të cilit/cilës i delegohet një funksion i tillë nga ai. Përveç matjeve sasiore të zbatueshmërisë së tij, vlerësimi i zbatimit do të marrë në konsideratë edhe instrumentet cilësorë të matjes, me ç'rast do të merren parasysh opinionet e të gjithë të punësuarve në administratë si dhe opinionet e eksponentëve të audiencave tjera të brendshme.

PJESA E DYTË: STRATEGJIA PËR KOMUNIKIM.TË JASHTËM

1. HYRJE

Kjo strategji e komunikimit të jashtëm, e mbështetur edhe nga strategjia për komunikim të brendshëm, vendos kornizat e mekanizmit komunikues dhe një kulture organizative që do të mundësojë arritjen e objektivave kryesorë përkthazi me komunikimin e hapur dhe ndërveprimin me një gamë të gjerë audiencash. Qëllimi i kësaj strategjie është që të përcaktojë kërkesat dhe modalitetet e komunikimit për shpërndarjen e informacionit të publiku, partnerët dhe hisedaret. Strategjia do të shërbejë si udhërrëfyes për komunikimet e jashtme dhe do të azhurnohet sipas nevojave dhe kërkesave të kohës.

Strategjia për komunikim të jashtëm do të shërbejë si një bazament për diversifikimin e komunikimit me qëllim të fuqizimit të informimit publik, ndërtimin e partneritetit të komunës me qytetarët, rritjen e transparencës, promovimin e vlerave dhe aseteve të komunës, e për rrjedhojë edhe përmirësimin e imazhit dhe reputacionit të komunës.

Aktivitetet e parapara me këtë strategji janë dizajnuar si rrjedhojë e një analize gjithëpërfshirëse të proceseve dhe mekanizmave të komunikimit dhe efikasitetit të tyre në performancën e komunës në disa elemente kyçe siç janë: transparencia, llogaridhënia, pjesëmarrja qytetare, perceptimet dhe kënaqshmërinë e publikut me shumë aspekte komunikuese, etj. Mbi bazën e kësaj analize janë identifikuar mundësitë për përmirësim, të cilat janë përkthyer në objektiva, mesazhe dhe kanale të komunikimit dhe mekanizma për marrjen e informatave kthyesë.

Qeverisja e mirë varet nga jetësimi i suksesshëm i disa elementeve kyçe të administrimit, siç janë transparencia, përfaqësimi, pjesëmarrja, përgjegjësia, llogaridhënia, efektiviteti dhe efikasiteti, si dhe sundimi i ligjit. Vizioni i Komunës së Gjakovës është që të përfaqëjë të gjitha këto elemente duke i përkthyer ato në objektiva parësorë të kësaj strategjie. Qytetarët e komunës, mediat dhe organizatat e shoqërisë civile, grupimet profesionale, komuniteti i biznesit, donatorët, institucionet qeveritare, por edhe mbështetësit e Komunës së Gjakovës, do të jenë partnerë të rëndësishëm në konceptimin dhe menaxhimin e aktiviteteve të komunës.

2. QASJA

Komuna e Gjakovës në tre vitet vijuese do t'i kushtojë një vëmendje të merituar praktikave të komunikimit me aktorët e jashtëm. Për këtë arsye do të bëhen aranzhimet e nevojshme që të sigurohen burimet e mjaftueshme njerëzore dhe financiare për të përmbushur objektivat e komunikimit të përcaktuara me këtë strategji.

Komuna do të bashkëpunojë me qytetarë, organizata të shoqërisë civile, grupime profesionale dhe mbështetësit e donatorët tonë me qëllim që të ndërtojmë një klimë miqësore për avancimin e nivelit të qeverisjes në komunë. Po kështu, do të promovohet një partneritet i shëndoshë dhe me interes reciprok me sektorin privat me qëllim të promovimit të aspiratave të Komunës për të krijuar një ambient të përshtatshëm promovimin e zhvillimit ekonomik dhe për tërheqjen e investimeve të huaja në komunë.

Për këtë qëllim, Komuna do të krijojë mundësitë më të mira për ngritjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale të zyrtarëve për informim, kurse në raste të veçuara do të angazhojë edhe ekspertë të jashtëm me qëllim të avancimit të nivelit të komunikimeve në administratën komunale.

Për më tepër, Komuna do të vendosë marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet akademike (universitetet) me qëllim të përfitimit reciprok në ngritjen e cilësisë dhe performancës në punë.

3. GJENDJA AKTUALE

Sistemi i komunikimit në administratën e komunës është zhvilluar në mënyrë organike përgjatë viteve dhe praktikët e mira të evidentuara do të përbëjnë themelet për një komunikim më të planifikuar dhe më të strukturuar në të ardhmen. Progresi në aspektin e komunikimit, informimit publik, qasjes në dokumente zyrtare, transparencës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje është evidentuar edhe nga një sërë raportesh me metodologji të konsoliduar siç janë: Raporti i performancës së komunave të MAPL-së, Matësi i performancës në Prokurimin Publik (USAID, Demokracia Plus, 2019), Indeksi i Transparencës së Komunave në Prokurimin Publik 2018 (USAID dhe IKD, maj 2019) e së fundmi edhe nga Indeksi i Transparencës Buxhetore të Komunave (Instituti GAP, shtator 2019), i cili e rendit komunën e Gjakovës në vendin e parë me 97 nga 100 pikët e mundshme.

Gjetje pozitive janë regjistruar edhe me perceptimet e qytetarëve në relacion me performancën e komunës në sfera të ndryshme. Në sondazhet të përvitshme të USAID (*Sondazh i perceptimit të qytetarëve mbi korrupsionin dhe transparencën në prokurimin publik, USAID TEAM, 2017-2019*) besueshmëria e qytetarëve të Gjakovës në qeverinë lokale (në shkallaren 1 deri 7) del të jetë me vlera mbi mesataren – 3.70. Po ashtu, sondazhi tregon për një kënaqshmëri të konsiderueshme të qytetarëve me shërbimet publike (59%), me punën e administratës komunale (61%), e në veçanti me projektet publike infrastrukturore (61%) dhe investimet kapitale (85%).

Sa i përket nivelit të informimit përkitazi me punën e komunës, 45% e të anketuarve janë shprehur se janë të mirinformuar apo deri diku të informuar. Kur është fjala të pjesëmarrja e qytetarëve proceset vendimmarrëse, vërehet një tendencë e dukshme e rritjes së numrit të atyre që kanë marrë pjesë të paktën njëherë në aktivitete të tilla si: mbledhjet e kuvendit të komunës (nga 20% në 39.7%), debate publike (nga 28.4% në 57.8%), takime të nivelit komunitar (nga 1.8% në 38.8%), sikurse që evidentohet një rritje e lehtë edhe në takimet publike për projektet kapitale (nga 7.3% në 8.6%).

Pavarësisht nga progresi i shënuar, komuna përmes kësaj strategjie do të promovojë forma inovative të nxitjes së qytetarisë aktive dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje.

Prania e komunës në media vazhdon të përbëjë një sfidë për disa arsye. Së pari, në territorin e komunës së Gjakovës aktualisht operojnë vetëm një radio lokale (Radio Gjakova) dhe një televizion (Syri Vizion - me të cilin komuna ka marrëdhënie bashkëpunimi në transmetimin e seancave të Kuvendit dhe informacioneve të komunës); së dytë, nuk ka ndonjë medium online (portal) me karakter informues në territorin e komunës që mbulon me konsistencë ngjarjet dhe aktivitetet e komunës, dhe së treti, transmetuesit me licencë kombëtare (RTK, KTV, RTV21) dhe mediat online me mbulueshmëri të madhe pavarësisht se përcjellin ngjarjet dhe aktivitetet e komunës, interesimi dhe relevanca e mbulimit të shumë për të dëshiruar. Në vitet vijuese komuna

do të kërkojë forma alternative për të rritur praninë e saj në media duke u mbështetur te mundësitë që ofrojnë kanalet e komunikimit digjital, burimet e brendshme njerëzore.

Një tjetër aspekt që kërkon trajtim më të avancuar është edhe prania në platformat sociale. Në momentin aktual, Komuna e Gjakovës është e pranishme në platformën sociale Facebook. Duke pasur parasysh ritmet e komunikimit dhe tendencat e burimeve të informimit në epokën e digjitalizimit, prania në platformat tjera sociale – Instagram (që po shënon rritje me ritme të larta), Flickr (platformë për ndarjen e fotografive profesionale dhe me rezolucion të lartë), YouTube (platformë për ndarjen e videove profesionale me rezolucion të lartë), apo ndonjë tjetër – është një aspekt që do të adresohet në një kohë sa më të shpejtë me qëllim të hapjes së sa më shumë kanaleve të komunikimit.

E fundit, por jo për nga rëndësia, në një stad zhvillimi që ka arritur sot, komuna ka nevojë që të rrisë ndjeshëm nivelin e komunikimit korporativ – njësiive autentike të vizibilitetit dhe sidomos në promovim të aseteve dhe pasurive të trashëgimisë kulturore, historike, turistike apo ekonomike. Komuna duhet të hulumtojë për forma kreative dhe ekonomiksht të përballueshme në promovimin e vlerave të saj, qoftë në formë të printuar apo digjitale. E gjithë kjo duhet të kulminojë (në vitin 2021) me hartimin e një strategjie të konsoliduar për marketingun dhe brendimin e komunës.

4. OBJEKTIVAT


Zhvillimet e hovshme në sferën e teknologjisë kanë transformuar në mënyrë rrënjesore edhe praktikatat e komunikimit në përgjithësi. Në njërin anë kemi të bëjmë me rritjen e përdorimit të pajisjeve të teknologjisë informative që po udhëheq drejt ndryshimeve rrënjesore në shoqëri, e nga ana tjetër, si pasojë e burimeve të kufizuara (njerëzore dhe financiare) në standardizimin të teknologjisë, administratat komunale po përballen me vështirësi në adresimin efikas të kërkesave në rritje të qytetarëve.

Synimi parësor i kësaj Strategjie është që t'i mundësohet qytetarëve të komunës jo vetëm një qasje e lehtësuar në informacionet mbi aktivitete të komunës, por edhe të nxisë përfshirjen e tyre në procesin e vendimmarrjes. Përmes kësaj strategjie Komuna kërkon të instalojë një qasje komunikimi e cila merr në konsideratë preferencat e qytetarëve dhe audiencave tjera dhe për rrjedhojë hap shtigje për ndërtimin e një klime mirëbesimi.

Nga sa u tha më sipër dhe duke marrë parasysh analizën e gjendjes ekzistuese të cilësisë së komunikimeve të paraqitur në seksionin paraprirë, objektivat e përcaktuar të arrihen përmes kësaj strategjie janë si në vijim:

1. Komunikim më robust me publikun duke vënë në përdorim mundësitë që ofrojnë mediat e reja dhe platformat e komunikimit digjital
2. Promovimi i transparencës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje si parakusht për ndërtimin e një besimi reciprok me publikun

3. Komunikim korporativ që është në funksion të rritjes së dukshmërisë së komunës dhe promovimit të vlerave dhe aseteve të saj konkurruese – marketingu dhe brendimi i komunës.



Komunikim më robust do të synohet përmes paraqitjeve të strukturuar mediale, diversifikimit të kanaleve dhe materialeve komunikuese, përdorimit të shtuar të mediave të reja dhe digjitale dhe ndërveprimit të shtuar përmes faqes zyrtare të komunës në Internet. Në vitet në vijim, komuna synon që të risë praninë e saj në platformat sociale, si në aspektin sasior ashtu edhe në cilësor. Përpara hapjes së llogarive në platformat e tjera sociale, ne do të sigurohemi që personeli në ZKP të trajnohet për përdorimin korrekt dhe efikas të tyre. Në këtë drejtim do të kërkojmë përkrahjen e partnerëve tanë, organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve akademike që operojnë në komunë dhe jashtë saj.

Promovimi i transparencës dhe nxitja e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje janë indikatorët më të rëndësishëm të besimit reciprok dhe demokracisë së drejtpërdrejtë. Komuna do t'i kushtojë një vëmendje të veçantë konceptimit, planifikimit dhe organizimit të dëgjimeve buxhetore duke siguruar transparencë, kushte për pjesëmarrje sa më të

madhe si dhe interaksion (ndërveprim). Ndërlidhja e vizonit të komunës dhe prioriteteve strategjike me planet dhe programet zhvillimore janë një qasje efektive në përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje. Paraqitja vizuale e vizonit zhvillimor, objektivave strategjikë dhe programet e mundshme për arritjen e tyre janë një mënyrë e duhur për pjesëmarrje, përfaqësim dhe transparencë në procesin e buxhetimit. Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje synohet të arrihet përmes adoptimit të formave të reja të organizimit të takimeve, publike, dëgjimeve buxhetore, konsultimeve për nismat dhe projektet e rëndësishme kapitale, ndërmarrjen e fushatave informuese dhe projekte komunitare, si dhe duke ofruar qasje të plotë në dokumentet zyrtare sipas parimeve të Open Data. Konsultimet publike janë një kërkesë ligjore e komunave në procesin e vendimmarrjes. Pavarësisht nga kjo, përfshirja e qytetarëve, hisedarëve, grupeve të interesit dhe organizatave të shoqërisë civile në procesin e vendimmarrjes përbëjnë një parakusht për një vendimmarrje cilësore dhe gjerësisht të pranueshme. Konsultimet publike mund të organizohen si përmes takimeve të drejtpërdrejta ashtu edhe duke vënë në shfrytëzim platformat dhe aplikacionet online.

Një komunikim më efikas dhe më funksional korporativ përfshin një gamë të gjerë veprimesh që kanë për qëllim ndërtimin e imazhit, identitetit vizual, marketingut, brendimit të Komunës dhe do të nisë fillimisht me dizajnimin dhe prodhimin e njëjësive standarde të dukshmërisë, gjë e cila në fazat e mëvonshme do të pasohet me hartimin e një Strategjie komunale për Marketing dhe Brendim. Mënyra se si Komuna e përfaqëson veten, imazhin, vlerat dhe asetet e saj është shumë e rëndësishme në rritjen e interesit të atyre që duan ta vizitojnë Komunën në përgjithësi, si dhe në nxitjen e investimeve në veçanti.

5. PLATFORMA PËR KOMUNIKIM TË JASHTËM

Platforma e komunës për komunikim të jashtëm mbështetet në të drejtën e qytetarëve, mediave, organizatave të shoqërisë civile, hisedarëve dhe partnerëve për qasje të lirë, të drejtë dhe të kohshme në dokumentet zyrtare. Komuna do të bëjë gjithçka që është e mundur që t'i mësojë nevojat, brengat dhe pritjet e qytetarëve dhe t'i adresojë ato në një mënyrë efektive. Ndërveprimi me publikun dhe audiencat relevante do të jetë i vazhdueshëm, i hapur, gjithëpërfshirës, relevant dhe në besim reciprok.

Kjo platformë mbështetet në tre shtylla kryesore:

Konsistenca – informacione të standardit të lartë dhe të mirë-përgatitura (që bazohen në kërkesat e publikut dhe audiencave specifike) në përputhje me kulturën organizative, vlerat dhe vizionin e administratës komunale.

Besueshmëria – komuna ofron informacione të sakta dhe të kohshme që promovojnë transparencën dhe ndërveprimin me publikun dhe audiencat.

Dukshmëria - Komuna do të përkujdeset që veprimet e saj të dukshme, të qasshme dhe llogaridhënëse. Prania e Komunës do të jetë e dallueshme përmes njësive identitare të standardizuara të komunikimit, që nga ambientet në qendrën për shërbim të qytetarëve e deri te projektet kapitale të financuara nga buxheti jonë. Kjo do të arrihet përmes zhvillimit të njësive të vizibilitetit në të gjitha nivelet dhe shfaqjes së tyre në të gjitha format e komunikimit.

6. KANALET E KOMUNIKIMIT

Duke marrë parasysh zhvillimet e hovshme të mediave të reja dhe prezencën relativisht të varfër të mediave online (portaleve) që operojnë në territorin e Komunës, Gjakova do të rishikojë kanalet e komunikimit me audiencë të jashtme në mënyrë që aktivitetet, nismat dhe projektet e ndërmarra të pasqyrohen me korrektësi dhe të marrin vëmendjen e merituar të publiku.

Webfaqja e Komunës <https://kk.rks-gov.net/gjakove/> mbetet kanali më i rëndësishëm i komunës për komunikim zyrtar me audiencat e jashtme. Vështirësitë e hasura pas ridizajnit të faqes zyrtare të komunës po tejkalohen gradualisht dhe në muajt në vijim ajo duhet të ushqehet me informacionet relevante në funksion të informimit publik dhe qeverisjes së mirë dhe transparente.

Webfaqja alternative e komunës <http://gjakovaportal.com/al/> është një burim tjetër i informimit, i cili do të ridizajnohet për t'u vënë më shumë në funksion të promovimit të zhvillimit ekonomik, aseteve të trashëgimisë kulturore dhe historike, potencialit turistik të komunës, informimit të vizitorëve, turistëve, donatorëve dhe investitorëve të huaj. Ridizajnimi i kësaj faqe do të jetë pjesë e një strategjie të veçantë për marketingun dhe brendimin e komunës që do të nisë në fillim të vitit 2021.

Mediat online dhe platformat e komunikimit social - Zyra për Informim ka një listë të konsoliduar të të gjitha mediave tek të cilat përgjellë të gjitha ngjarjet që meritojnë vëmendjen e publikut. Duke pasur parasysh rritjen dramatike të popullaritetit të mediave të reja (digjitale), komuna duhet të kërkojë për forma më efikase të komunikimit me to, duke përfshirë edhe mënyrën e strukturimit të lajmeve për konsum nga mediat online. Në momentin aktual, Komuna e Gjakovës është e pranishme vetëm në platformën sociale Facebook. Duke u nisur nga kjo e sidomos duke pasur parasysh numrin solid të zyrtarëve në Zyrën për Informim Publik, prania në platformat tjera sociale – Instagram (që po shënon rritje me ritme të larta), Flickr (platformë për ndarjen e fotografive profesionale dhe me rezolucion të lartë), YouTube (platformë për ndarjen e videove profesionale me rezolucion të lartë), apo ndonjë tjetër - është një aspekt që do të adresohet që në vitin e parë (2021) me qëllim të hapjes së sa më shumë kanaleve të komunikimit digjital dhe përfshirjes së sa më shumë audiencave në komunikimet e ditëpërditshme.

Format inovative të takimeve komunitare – janë një mënyrë e mirë për të rrëzuar barrierat e komunikimit që ndërtohen në nivel komunitar si pasojë e qasjes së munguar në

informacion. Takime të llojit World Café apo Coffee Klatch (takime në vende të frekuentuara në komunitete, fshatra dhe lagje të ndryshme) janë shumë efektive për drejtuesit e komunës për diskutimin e çështjeve me interes për komunitetin në një ambient joformal.

Takime të strukturuar dhe të planifikuara për organizimin dhe udhëheqjen e takimeve publike të natyrave konsultative – takimet dhe debatet publike, takimet konsultative, dëgjimet buxhetore, takimet komunitare për nisma dhe projekte kapitale, etj.

Paraqitjet publike dhe në media – janë një formë efektive për t'iu drejtuar audiencave të ndryshme për çështje specifike dhe me rëndësi për zhvillimet në komunë. Në këtë kuader do të intensifikohen konferencat për shtyp (të rregullta dhe të rastit), intervistat dhe debatet në media, takime joformale me përfaqësuesit e mediave (takime të llojit *Meet the Press*, për shembull), Inaugurime dhe promovim e nismave të ndryshme, shkrime autoriale dhe opinione për çështje specifike që ndërliken me qeverisjen lokale, etj.

Publikimet⁴ janë një element aspekt kyç i punës së komunës dhe prezantimit të saj. Ana përmbajtësore dhe vizuale e publikimeve zyrtare do të rishikohet në mënyrë që të jenë më të kuptueshme dhe vizualisht më estetike, e për rrjedhojë edhe më të lexueshme nga publiku dhe grupet e interesuara. Po ashtu, si publikimet formale ashtu edhe ato me karakter promovimi dhe marketingu apo ato me karakter informimi e ndërgjegjësimi do të standardizohen në përputhje me parimet udhëheqëse të parapara me strategjinë e marketingut dhe brendimit.

Videot dhe fotografitë – Imazhet (videot dhe fotografitë) si kanal komunikimi meriton kategorizim të veçantë për faktin se rëndësia e tyre në komunikimet digjitale është rritur në mënyrë dramatike që nga dalja në skenë e platformave për komunikim social. Videot dhe fotografitë, edhe si të vetme dhe e pasqyruar me narracion, ka aftësinë për të kapur vëmendjen e audiencës, duke gjeneruar interesim dhe përfshirje emocionale. Stafi i Zyrës Komunale për Informim Publik do të trajnohet për t'i fituar shkathtësitë e nevojshme në krijimin, e imazheve profesioniste dhe editimit të tyre për nevojat e komunikimit me publikun.

Animacionet – janë mjete me kosto efektive për ta shpjeguar një proces në mënyrë të detajuar dhe janë atraktive veçanërisht për audiencat me moshë të re. Përveç manualeve dhe tutorialeve, animacionet janë një mjet efikas në përshkrimin e proceseve dhe procedurave për marrjen e shërbimeve të caktuara në komuna që për nga natyra janë formalisht më të ndërlikuara.

7. AUDIENCAT, MESAZHET DHE IMPAKTI I DËSHIRUAR

Që një komunikim të jetë efikas është me rëndësi që ai të jetë i dyanshëm dhe informatat kthyesë nga audiencat të jenë të sakta dhe të kohshme. Komunikimi i saktë, i plotë i kohshëm dhe përmes një kanali (mediumi) të duhur, por edhe kujdesi ndaj informatave kthyesë për të marrë mendimin dhe këndvështrimet e të tjerëve përbëjnë një ndihmesë të madhe në vendosjen e mirëbesimit dhe marrëdhënieve të shëndosha.

Përmes kësaj strategjie komuna e Gjakovës kërkon të vendosë marrëdhënie të shëndosha dhe me interes reciprok me një numër të madh audiencash duke përcjellë mesazhe e duhura te audiencat e duhura dhe duke respektuar mendimin e tyre në raport me çështjet e përbashkëta të interesit. Tabela më vijim, paraqet në formë të detajuar audiencat me të cilat synon të komunikojë komuna në një mënyrë të organizuar dhe të strukturuar përmes mesazheve të qarta dhe që nuk lënë hapësira për dëmtimin e marrëdhënieve reciproke.

AUDIENCA	MESAZHI: Çfarë duam që ata të mendojnë për ne?	IMPAKTI I DËSHIRUAR: Çfarë veprimesh presim nga ta?	KANALET E KOMUNIKIMIT Si do t'i arrijmë?
Qytetarët dhe Taksapaguesit e të gjitha kategorive	- Komuna e Gjakovës është e përkushtuar që përmirësojë cilësinë e qeverisjes dhe demokracinë. - Shërbimet e komunës janë me kosto të arsyeshme dhe janë në përmirësim çdo ditë. - Komuna mirëpret pjesëmarrjen dhe kontributin e qytetarëve në vendimmarrje. - Investimet kapitale në komunë planifikohen bashkërisht me ju dhe me pjesëmarrjen tuaj. - Komuna shpenzon me përgjegjësi dhe efikasitet paratë e taksapaguesve dhe, donatorëve që mbështesin projektet kapitale. - Komuna, çdo ditë e më tepër, po bën përpjekje për luftimin e korrupsionit dhe dukurive negative në shoqëri.	- Të shprehen pozitivisht për cilësinë e shërbimeve, qeverisjes dhe demokracisë në komunë. - Të kenë mirëkuptim për efikasitetin dhe koston e shërbimeve që marrin nga komuna. - Të kenë mirëkuptim për planifikimin e investimeve kapitale dhe rëndësinë e tyre për objektivat zhvillimor. - Të kenë një perceptim mbi përgjegjshmërinë dhe efikasitetin në shpenzimin e fondeve publike dhe kontributet e donatorëve dhe partnerëve ndërkombetare. - Të raportojnë veprimet abuzive dhe korrupsionin.	- Webfaqja e komunës - Webfaqja alternative - Mediat online dhe platformat sociale - Takime publike, takime konsultative, degjimet buxhetore, takimet komunitare, etj. - World Cafe, Coffee Klatch - Galeritë (Video dhe fotografi) - Publikimet periodike dhe të rastit

Mediat lokale nacionale ndërkombëtare

- Administrata komunale është shumë e motivuar për të nritur performancën e shërbimeve.
- Standardet e performancës tonë dhe cilësia e shërbimeve po rriten ditë për ditë.
- Komuna e Gjakovës i shpërndan paratë e taksapaguesve në mënyrë të përgjegjshme dhe në interes të zhvillimit të komunës.
- Ne jemi të hapur ndaj të gjitha interesimeve tuaja.
- Mbështetja juaj është e domosdoshme në luftimin e korrupsionit dhe formave të keqqeverisjes.
- Të mbulojnë ngjarjet që ndërlidhen me komunën në mënyrë të saktë, të sinqertë dhe të paanshme.
- Të raportojnë për nismat dhe projektet pozitive të komunës.
- Ta konsiderojnë administratën komunale një burim të besueshëm të informacionit.
- Të ofrojnë kontributin e tyre në përmirësimin e cilësisë së qeverisjes.
- Webfaqja e komunës
- Webfaqja alternative
- Platformat sociale
- Komunikata dhe lajme
- Video lajme
- Publikimet periodike dhe të rastit
- Konferenca për shtyp
- Takime të llojit "Meet the Press"
- Intervista
- Shkime dhe kontribute profesionale për çështje të caktuara

Organizatrat e shoqërisë civile dhe organizatat profesionale

- Komuna është e hapur për bashkëpunim dhe mirëpret kontributin e OSHC-ve dhe organizatave profesionale.
- Komuna do të mbështesë nismat dhe projektet e shoqërisë civile që kanë për synim përmirësimin e cilësisë së standardeve demokratike në komunë.
- OSHC-të janë një aleat i besueshëm i komunës në luftimin e korrupsionit dhe dukurive negative në shoqëri.
- Ta konsiderojnë komunën si partner të rëndësishëm në mbështetjen e nismave dhe kauzave të tyre.
- Të marrin pjesë aktivisht në vendimmarrje.
- Të mbështesin përpjekjet e komunës për qeverisje gjithëpërfshirëse.
- Të kontribuojnë në përmirësimin e shërbimeve komunale.
- Webfaqja e komunës
- Webfaqja alternative
- Mediat online dhe platformat sociale
- Takime publike, takime konsultative, dëgjime buxhetore, takimet komunitare
- Nisma dhe organizime të përbashkëta
- Publikimet periodike dhe të rastit

**Komuniteti i
biznesit dhe
investitorët e
mundshëm**

- Komuna e Gjakovës nxit krijim e një ambienti miqësor për të bërë biznes.
- Politikat tona fiskale janë të favorshme për zhvillimin e biznesit.
- Komunes i intereson mendimi dhe kontributi i komunitetit të biznesit në avancimin e klimës afaniste në komunë.
- Administrata komunale është e përkushtuar që të rrisë nivelin e cilësisë së shërbimeve
- Komuna synon të jetë një vend i mundësive dhe nxitëse e inovacionit.
- Ta konsiderojnë komunën si një partner të besueshëm në zhvillimin e bizneseve të tyre.
- Të flasin pozitivisht për nismat dhe përpjekjet e komunës në përmirësimin e ambientit afanist në komunë.
- Të kontribuojnë profesionalisht në përmirësimin e politikave dhe strategjive zhvillimore.
- Të inkurajojnë investitorët e huaj të investojnë në Gjakovë.
- Webfaqja e komunës
- Webfaqja alternative
- Mediat online dhe platformat sociale
- Takimet konsultative, degjimet buxhetore,
- Publikimet periodike dhe të rastit
- Nisma dhe organizime të përbashkëta

**Komuniteti
akademik/
Universitetet**

- Komuna e Gjakovës është e hapur për bashkëpunim dhe mirëpret kontributin e personelit akademik dhe studentëve në avancimin e politikave dhe strategjive për zhvillimin e komunës.
- Komuna është e interesuar që të bashkërisht të ndërmarrim studime dhe hulumtime që mbështesin qeverisjen e mirë dhe zhvillimin e komunës.
- Ne kemi ekspertizën e duhur që të ndihmojmë punën tuaj kërkimore shkencore
- Të ndërmarrin iniciativë për studime dhe hulumtime në fushën e qeverisjes lokale
- T'i referohen praktikave tona në punën kërkimore shkencore.
- Të kenë konsideratë të lartë ndaj ekspertizës tonë në sferën e qeverisjes lokale.
- Webfaqja e komunës
- Webfaqja alternative
- Mediat online dhe platformat sociale
- Nisma dhe organizime të përbashkëta
- Shkëmbime të formalizuara
- Takime konsultative
- Publikimet periodike dhe të rastit

Institucionet e Kosovës (Qeveria Kuvendi i Republikës Zyrtarët publikë) Opinionbërësit Personalitet me peshë	• Mbështetja e Qeverisë është jashtëzakonisht e rëndësishme për zhvillimin e komunës. • Administrata komunale është shumë e motivuar për të rritur performancën e shërbimeve. • Administrata komunale ka një impakt të madh në rritjen e cilësisë së jetës në komunë. • Investimet kapitale janë gjithmonë të menduara mirë dhe në përputhje me vizionin zhvillimor të komunës.	• Të mbështesin vizionin tonë për zhvillim të komunës. • Të kenë parasysh specifikat e komunës dhe nevojave për fonde shtesë. • Të mbështesin nismat tona dhe kërkesat për investime kapitale. • Të mbështesin kërkesat tona për zhvillimin profesional të personelit të administratës komunale.	• Webfaqja e komunës • Webfaqja alternative • Mediat online dhe platformat sociale • Takime konsultative, dëgjimet buxhetore, • Publikimet periodike dhe të rastit • Shkrime dhe kontribute profesionale për çështje të caktuara
Partnerët ndërkombëtarë dhe donatorët	• Komuna e Gjakovës është e përkushtuar të përmirësojë cilësinë e qeverisjes. • Komuna e Gjakovës është e përkushtuar që të forcojë sundimin e ligjit. • Komuna e Gjakovës i mirëpret dhe i shfrytëzon kontributet e donatorëve në mënyrë efektive dhe të përgjegjshme. • Komuna e Gjakovës është një partner i besueshëm që kujdeset për qëndrueshmërinë e projekteve dhe investimeve.	• Të flasin me pozitivitet mbi bashkëpunimin dhe partneritetin me komunën. • Të na mbështesin në avokimin për grumbullimin e fondeve për qëllime zhvillimore. • Të përdorin autoritetin e tyre për më shumë fonde për komunën e Gjakovës. • Të mbështesin komunën në rritjen e cilësisë së qeverisjes dhe demokracisë. • Të mbështesin komunën në forcimin e rendit dhe ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut.	• Webfaqja e komunës • Webfaqja alternative • Mediat online dhe platformat sociale • Takime të rregullta bashkërenduese • Nisma dhe organizime të përbashkëta. • Pjesëmarrje të rregullta në ngjarjet me relevancë për qeverisjen lokale • Publikimet periodike dhe të rastit

8. PLANI VJETOR PËR KOMUNIKIM TË JASHTËM

Zbatimi efikas i kësaj strategjie do të mbështetet në planin vjetor të veprimil.

9. VLERËSIMI I PLANIT TË KOMUNIKIMIT TË JASHTËM

Vlerësimi i impaktit të strategjisë për komunikim të jashtëm do të bëhet mbi bazën e indikatorëve të përcaktuar më poshtë, të cilët janë specifik, të matshëm dhe lehtësisht të verifikueshëm.

10. INDIKATORËT E IMPAKTIT TË KOMUNIKIMIT TË JASHTËM

Indikatori	Fillestarja 2019	Synimi 2021	Synimi 2022	Synimi 2023
Shkalla e besueshmërisë së qytetarëve (nga 1-7) ndaj qeverisë komunale në raportin e USAID: "Perceptimi i qytetarëve mbi korrupsionin dhe transparencën në Prokurimin publik"	3.70 (shkallari nga 1 deri në 7)	3.90	4.10	4.50
% e qytetarëve të kënaqur dhe deri diku të kënaqur me shërbimet publike në raportin e USAID: "Perceptimi i qytetarëve mbi korrupsionin dhe transparencën në Prokurimin publik"	59%	61%	63%	65%
% e qytetarëve të kënaqur dhe deri diku të kënaqur me punën e administratës komunale në raportin e USAID: "Perceptimi i qytetarëve mbi korrupsionin dhe transparencën në Prokurimin publik"	61%	63%	65%	67%
Performanca e Komunës në kategorinë e transparencës të raporti Indeksi i Transparencës së Komunave në Prokurimin Publik (USAID dhe IKD)	21.88 (nga 25 pikë max.)	23.00	25.00	25.00
% e qytetarëve të kënaqur dhe deri diku të kënaqur me cilësinë e projekteve publike në raportin e USAID: "Perceptimi	64%	67%	68%	70%

i qytetarëve mbi korrupsionin dhe transparencën në Prokurimin publik*				
% e realizimit të indikatorëve të performancës në Kategorinë 2 në Sistemin e Menaxhimit të Performancës së Komunave të Kosovës (MAPL)	77.71%	85%	95%	100%
Vlerësimi i performancës së komunës në Indeksin e Transparencës Buxhetore (pikë) të Institutit GAP	97	100	100	100
# total vjetor i vizitave në websajtin e komunës	200 K	220 K	240 K	270 K

11. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË KYÇE

Zyrtari	Rolet dhe përgjegjësitë
Kryetari i Komunës	<i>Nxit, promovon dhe mbështetë kulturën e komunikimit të hapur dhe efikas brenda administratës komunale dhe kujdeset për një komunikim të shëndoshë me audiencat e jashtme Siguron që komunikimi me të gjitha audiencat e synuara të jetë i kohshëm, i saktë, dhe në funksion të bashkërendimit efikas.</i>
Kryetari & Nënkryetari i Komunës	<i>Mbikëqyrin zbatimin e Strategjisë për Komunikim Ndërmarrin veprime të konkrète me qëllim të zbatimit efikas të kësaj strategjie dhe mbikëqyrjes së saj Janë përgjegjës për vlerësimin periodik (vjetor) të zbatimit të kësaj strategjie.</i>
Drejtorët e drejtorive komunale	<i>Nxisin dhe mbikëqyrin zbatimin e kësaj strategjie brenda drejtorive të tyre dhe informojnë Kryetarin dhe Nënkryetarin e komunës për progresin në zbatimin e saj</i>

	<i>Furnizojnë Zyrën për Komunikim me Publikun me informacione të cilat meritojnë publicitet dhe vëmendje të publikut.</i> <i>Koordinohen me Zyrën për Komunikim me Publikun dhe me Kabinetin e Kryetarit për paraqitjet e tyre në media dhe publik.</i> <i>Informojnë personelin e drejtorive me të cilat udhëbeqin me zhvillimet që ndërlidhen me administratën komunale dhe Kuvendin e Komunës dhe inkurajojnë shprehjen e lirë të tyre në planifikim dhe vendimmarrje.</i>
Zyra Komunale për Informim	<i>Është përgjegjëse për të mirëmbajtjen e faqes zyrtare të komunes në internet dhe llogarive në platformat sociale.</i> <i>Është përgjegjëse për informimin e saktë dhe të kohshëm përmes kanaleve të komunikimit në dispozicion të komunes.</i> <i>Kontribuon në pasurimin e formave të komunikimit dhe mbanë të informuar Kryetarin e Komunës për mbarëvajtjen e komunikimit të jashtëm.</i> <i>Në bashkëpunim me kabinetin e kryetarit sigurohet për zbatimin e plotë të Planit të Transparencës.</i> <i>Sigurohet që të punësuarit e administratës dhe audiencat tjera të kenë informacionet e nevojshme mbi ngjarjet që ndërlidhen me ekzekutivin e komunës.</i>
Të punësuarit në administratën komunale	<i>Kontribuojnë në format që zgjedhin ata për të përmirësuar praktikën e komunikimit në administratën komunale.</i> <i>Bashkëpunojnë në mënyrë konstruktive me eprorët e tyre në funksion të përmirësimit të komunikimit horizontal dhe vertikal</i>

12.BUXHETI

KOSTOJA E PËRGJITHSHME E ZBATIMIT TË STRATEGJISË

Zbatimi i plani të veprimit për komunikim të brendshëm për vitin 2021	7,850.00 €
Zbatimi i plani të veprimit për komunikim të jashtëm për vitin 2021	19,600.00 €
GIJTHSEJT	27,450.00 €

13.SHTOJCAT

Shtojca 1. Plani i veprimit për komunikim të brendshëm

AKTIVITETE TË VEÇANTA

VEPRIMI	PËRGJEGJËSIA	KOHA	KOSTOJA
<i>Krijimi i listave të grupuara të kontakteve me audiencat për komunikim të brendshëm</i>	<i>Shefi i kabinetit të kryetarit dhe Zyra për Informim</i>	<i>Java 2 e janarit</i>	<i>Pa kosto shtesë</i>
<i>Rishikimi i zbatimit të Programit të Trajnimeve dhe Azhurnimi i databazës për ngritje teknike profesionale</i>	<i>Nënkryetari i komunës Shefi i kabinetit të kryetarit</i>	<i>Java 3 e janarit</i>	<i>Pa kosto shtesë</i>
<i>Miratimi i Planit të detajuar vjetor të Kuvendit (aktet dhe rregulloret e planifikuara për vitin 2021)</i>	<i>Kryetari i Komunës Kryesuesi i Kuvendit Drejtorët e drejtorive Njësia e Kuvendit</i>	<i>Java 3 e janarit</i>	<i>Pa kosto shtesë</i>
<i>Hartimi i udhëzimeve për komunikim me email me audiencat e brendshme dhe të jashtme</i>	<i>Shefi i kabinetit të kryetarit Zyra për Informim</i>	<i>Java 4 e janarit</i>	<i>Pa kosto shtesë</i>
<i>Konceptimi i formave të standardizuara të raportimit (raportimet periodike dhe raportimet për ecurinë e nismave dhe projekteve)</i>	<i>Shefi i kabinetit të kryetarit Eksperti i komunikimeve</i>	<i>Java 3 dhe 4 e janarit</i>	<i>1,000 € (ekspert i jashtëm për komunikim)</i>
<i>Trajnim: Kultura organizative dhe rruga drejt ndryshimeve (opcionale)</i>	<i>Nënkryetari komunës Eksperte për zhvillim organizativ</i>	<i>Java 1 e shkurtit</i>	<i>600 € (ekspert i jashtëm)</i>
<i>Dizajnimi i programit të induksionit për të sapo punësuarit në administratë</i>	<i>Nënkryetari komunës Njësia e personelit</i>	<i>Java 2 e shkurtit</i>	<i>Pa kosto shtesë</i>

<i>Pilotimi i praktikave të reja të raportimit (me përmbajtje dhe stil të ri)</i>	<i>Kryetari komunës Nënkryetari i komunës Shefi i kabinetit të kryetarit</i>	<i>Java 3 e shkurtit</i>	<i>Pa kosto shtesë</i>
<i>Zhvillimi i konceptit dhe formatit të Takimeve të Përgjithshme të Personelit (me pjesëmarrjen e të gjithë të punësuarve)</i>	<i>Kryetari i komunës Drejtorët e drejtorive Zyrtari për logjistikë Zyrtarët për Teknologji të Informacionit</i>	<i>Java 4 e shkurtit</i>	<i>Pa kosto shtesë</i>
<i>Organizimi i punëtorisë mbi praktikat e reja të raportimit dhe stilin e të shkruarit – rezultatet e pilotimit</i>	<i>Shefi i kabinetit të kryetarit Eksperti i komunikimeve</i>	<i>Java 2 e prillit</i>	<i>450 €</i>
<i>Takimi i Përgjithshëm me Personelin e administratës</i>	<i>Kryetari i komunës Shefi i kabinetit të kryetarit Njësia e personelit</i>	<i>Java 1 e majit</i>	<i>300 € (pagesa për ambientin)</i>
<i>Vlerësimi i funksionalitetit të praktikave të reja të raportimit</i>	<i>Kryetari komunës Nënkryetari i komunës Shefi i kabinetit të kryetarit Drejtorët e drejtorive</i>	<i>Java 1 e korrikut</i>	<i>Pa kosto shtesë</i>
<i>Konferenca Vjetore (dyditore) me pjesëmarrjen e zyrtarëve me përgjegjësi menaxhuese në komunë</i>	<i>Kryetari i komunës Nënkryetari i komunës Shefi i kabinetit të kryetarit</i>	<i>Java 4 e nëntorit</i>	<i>1,500 €</i>
<i>Vlerësimi i zbatimit të planit vjetor të komunikimit të brendshëm mbi bazën e indikatorëve të performancës</i>	<i>Kryetari i komunës Nënkryetari i komunës Shefi i kabinetit të kryetarit Drejtorët e drejtorive</i>	<i>Java 2 e dhjetorit</i>	<i>Pa kosto shtesë</i>
<i>Festa e fundvitit me personelin e administratës dhe mysafirëve të ftuar – shpërblimet për performuesit më të dalluar</i>	<i>Kryetari i komunës Nënkryetari i komunës Shefi i kabinetit të kryetarit Drejtorët e drejtorive</i>	<i>Java 3 e dhjetorit</i>	<i>4.000 €</i>

AKTIVITETET E PËRSËRITURA :

AKTIVITETI	PËRGJEGJËSIA	FREKUENCA
<i>Takimet bashkërenduese të kryetarit me kryesuesin e kuvendit dhe KPF-në</i>	Shefi i kabinetit të kryetarit Njësia e Kuvendit të Komunës	Para secilës seancë dhe sipas nevojës
<i>Takime e drejtorëve të drejtorive me zyrtarët e linjës</i>	Drejtorët e drejtorive	Në baza javore
<i>Transmetime Direkt të Mbledhjes së Bordit të Drejtorëve</i>	Kryetari i komunës Zyra për Informim Publik Zyrtarët e Teknologjisë së Informacionit	Në baza javore
<i>Raportet e konsoliduara periodike të administratës komunale</i>	Kryetari komunës Nënkryetari i komunës Shefi i kabinetit të kryetarit	Në baza mujore
<i>Takimet një-në-një brenda drejtorive/sektorëve</i>	Drejtorët e drejtorive komunale	Sipas nevojës
<i>Takimet e bordit të drejtorëve</i>	Kryetari i komunës Shefi i kabinetit të kryetarit Nënkryetari i komunës Drejtorët e drejtorive komunale	Në baza javore
<i>Programi i induksionit</i>	Nënkryetari komunës Njësia e personelit Drejtorët e drejtorive Njësia e personelit Zyrtarët e Teknologjisë së Informacionit	Me rastin e rekrutimit të personelit të ri
<i>Takime të përgjithshme me personelin e administratës komunale</i>	Kryetari i komunës Shefi i kabinetit të kryetarit Nënkryetari i komunës Njësia e personelit	Dy herë në vit
<i>Pjesëmarrja e të punësuarve në trajnime</i>	Nënkryetari komunës Njësia e personelit Drejtorët e drejtorive Njësia e personelit	Sipas programit dhe sipas ftesave nga organizatorët

Informim i rregullt dhe i strukturuar i të punësuarve mbi ngjarjet dhe zhvillimet që ndërlidhen me administratën komunale dhe Kuvendin e Komunës.

*Kryetari komunës
Nënkryetari i komunës
Shefi i kabinetit të kryetarit*

Sa herë që ka zhvillime që ia vlejnë të ndahen me të punësuarit (arritje, ngjarje, këshillime, etj.)

Video konferencat

*Kryetari i komunës
Zyrtarët e Teknologjisë së Informacionit*

Sipas kërkesës së kryetarit të komunës

**Kostoja preliminare:
7,850.00 EURO**

Shtojca 2. Plani vjetor për komunikim të jashtëm

AKTIVITET TË VEÇANTA:

AKTIVITETI	PËRGJEGJËSIA	KOHA	KOSTO (€)
<i>Krijimi i listave të kategorizuara të kontakteve me audiencat e jashtme</i>	<i>Shefi i kabinetit të kryetarit Zyra për Informim Publik Zyra për Teknologji të Informacionit</i>	Janar 2021	Pa kosto shtesë
<i>Miratimi i Planit të Transparencës 2021-2023 në Kuvend</i>	<i>Zyra për Informim Publik Kryetari i Kuvendit të Komunës</i>	Janar 2021	pa kosto shtesë
<i>Zhvillimi i njësive të identitetit vizual</i>	<i>Nënkryetari i komunës Zyra për Informim Publik Këshilltar i jashtëm</i>	Janar 2021	600€ (400 dizajni + 200 ekspertit)
<i>Formimi i grupit punues për identifikimin e mangësive të identifikuar në indikatorët e transparencës</i>	<i>Nënkryetari i komunës Zyra për Informim Publik Këshilltar i jashtëm</i>	Janar 2021	Pa kosto shtesë (opsion me mbështetje nga projekti USAID TEAM)
<i>Nënshkrimi i marrëveshjes me operator për shërbime audiovizive (EO, Kosovapress, apo ndonjë tjetër)</i>	<i>Kryetari i Komunës Drejtoria për Buxhet dhe Financa Zyra për Informim Publik</i>	Shkurt 2021	5,000€
<i>Prezantimi i mangësive të identifikuar në indikatorët e transparencës dhe masat</i>	<i>Nënkryetari i komunës Zyra për Informim Publik Këshilltar i jashtëm</i>	Shkurt 2021	Pa kosto shtesë
<i>Tryezë e rrumbullakët tematike: "Përmirësimi i ambientit të të bërit biznes në komunën e Gjakovës"</i>	<i>Kryetari i Komunës Kryetari Kuvendit Drejtori për Zhvillim Ekonomik</i>	Shkurt 2021	500€

<i>Takim me përfaqësuesit e sektorit të turizmit dhe hotelerisë dhe shoqatat e asociacionet relevante (Tema: Opsionet për promovimin e aseteve për turizëm kulturor)</i>	<i>Kryetari i Komunës Kryetari Kuvendit Drejtori për Zhvillim Ekonomik</i>	<i>Shkurt 2021</i>	<i>500€</i>
<i>Nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit me Universitetin</i>	<i>Kryetari i Komunës Kryetari Kuvendit</i>	<i>Shkurt 2021</i>	<i>Pa kosto shtesë</i>
<i>Takim koordinues me përfaqësuesit e organizatave dhe donatorëve që mbështesin komunën</i>	<i>Kryetari Komunës Kryesuesi i Kuvendit Drejtorët e drejtorive Zyra për Informim Publik</i>	<i>Shkurt 2021</i>	<i>750€</i>
<i>Hartimi i rregullores së brendshme mbi autorizimet për paraqitjet publike dhe përfaqësimin e komunës në publik</i>	<i>Kryetari i Komunës Kabineti i Kryetarit Zyra për Informim Publik</i>	<i>Mars 2021</i>	<i>Pa kosto shtesë</i>
<i>Publikimi i Raportit Vjetor të Kryetarit të Komunës (broshurë elektronike e dizajnuar)</i>	<i>Kabineti i Kryetarit Zyra për Informim Publik</i>	<i>Mars 2021</i>	<i>150€</i>
<i>Hartimi dhe prodhimi i fletëpalosjeve për parandalimin e korrupsionit në ofrimin e shërbimeve komunale</i>	<i>Nënkryetari i Komunës Zyra për Informim Publik Koordinator i Planit të Integritetit</i>	<i>Mars 2021</i>	<i>500€ (opsion: me mbështetje nga projekti USAID TEAM)</i>
<i>Trajnim (në vend të punës) mbi komunikimin dhe marketingun digjital për personelin në ZIP</i>	<i>Nënkryetari i Komunës Njësia e personelit Zyra për Informim Publik</i>	<i>Mars 2021</i>	<i>300€ (për trajnerin)</i>

<i>Hapja e konkursit me fotografi dhe video për garën "Vendet që duhet vizituar në Gjakovë"</i>	<i>Kabineti i Kryetarit Zyra për Informim Publik Njësia e Prokurimit</i>	Mars 2021	Pa kosto shtesë
<i>Takim tematik 1 i llojit "Meet the Press" i kryetarit të komunës në formatin e sallorit</i>	<i>Kryetari i Komunës Kabineti i kryetarit Zyra për Informim Publik</i>	Mars 2021	400€ (buffet)
<i>Konferenca e Kryetarit të komunës për paraqitjen e Raportit Vjetor 2019</i>	<i>Kryetari i Komunës Kabineti i Kryetarit Zyra për Informim Publik</i>	Prill 2021	Pa kosto
<i>Konferencat e drejtorëve të drejtorive komunale për paraqitjen e raporteve vjetore të punës</i>	<i>Drejtorët e drejtorive Zyra për Informim Publik</i>	Prill 2021	Pa kosto
<i>Tryezë e rrumbullakët – Parandalimi i korrupsionit në prokurimin publik</i>	<i>Kryetari i Komunës Zyra për Informim Publik OJQ-të lokale</i>	Prill 2021	1,500€ (me mbështetje të donatorëve)
<i>Lansimi i llogarisë së komunës në Intagram dhe YouTube</i>	<i>Zyra për Informim Publik Kabineti i Kryetarit</i>	Maj 2021	Pa kosto
<i>Takimi i 1-rë publik i Kryetarit të Komunës (Gjendja financiare, shpenzimet kapitale, investimet, etj.</i>	<i>Kryetari i Komunës Kabineti i Kryetarit Zyra për Informim Publik</i>	Maj 2021	Pa kosto
<i>Plani/Kalendari i dëgjimeve buxhetore</i>	<i>Kabineti i Kryetarit Kryetari i Kuvendit</i>	Maj 2021	Pa kosto
<i>Publikimi Broshurës elektronike "Investimet Kapitale në Komunë 2014-2021"</i>	<i>Kabineti i Kryetarit Zyra për Informim Publik</i>	Qershor 2021	600€

Takim tematik 2 i llojit "Meet the Press" i kryetarit të komunës në formatin e sallorit	Kryetari i Komunës Kabineti i Kryetarit Zyra për Informim Publik	Qershor 2021	400€ (buffet)
"Dita e Dyerve të Hapura" të Kryetarit të Komunës	Kryetari i Komunës Kabineti i Kryetarit Zyra për Informim Publik	Korrik 2021	500€ (ujë dhe pije freskuese)
Ridizajnimi i Gjakova Portal	Nënkryetari i Komunës Zyra për Informim Publik	Korrik/Gusht 2021	Pa kosto shtesë Me mbështetje të donatorëve)
Kuizi i Diturisë: Trashëgimia Kulturore dhe Historike e Gjakovës)	Kryetari i Komunës Sektori i Turizmit Sektori i Kulturës Zyra për Informim Publik	Shtator/Tetor 2021	2,000 (+ mbështetja nga donatorët)
Simpoziumi shkencor - Qeverisja Elektronike dhe sfidat (në bashkëpunim me MAPL dhe Universitetin)	Kryetari i Komunës Kabineti i Kryetarit	Tetor 2021	1,500€
Themelimi dhe takim nismëtar i grupit punues për hartimin e Strategjisë Komunale për Marketing dhe Brendim	Kryetari i Komunës Kryesuesi i Kuvendit	Nëntor 2021	400€
Takimi i 2-të publik i Kryetarit të Komunës (Gjendja financiare, shpenzimet kapitale, investimet, etj.	Kryetari i Komunës Kabineti i Kryetarit ZKP	Dhjetor 2021	Pa kosto

<i>Shpallja e fituesve të konkursit me fotografi dhe video për garën "Vendet që duhet vizituar në Gjakovë"</i>	Kryetari i Komunës Kabineti i Kryetarit ZKP	Dhjetor 2021	2.000€ (organizimi dhe shpërblimet për fituesit)
<i>Ndaja e fundvitit për donatorët dhe partnerët/mbështetësit vendorë e ndërkombëtarë</i>	Kryetari i Komunës Zyra për Informim Publik	Dhjetor 2021	2.000€

AKTIVITETET E PËRSËRITURA:
(Sipas rendit alfabetik)

AKTIVITETI	PËRGJEGJËSIA	SHPESHTËSIA
<i>Kolumna opinione në mediat online mbi aspekte të qeverisjes lokale</i>	Kryetari i Komunës Nënkryetari i Komunës Drejtorët e Drejtorive Stafi Profesional	Një herë në muaj
<i>Komunikata për shtyp</i>	Kabineti i Kryetarit ZIP	Gjatë gjithë kohës
<i>Konferenca për shtyp</i>	Kabineti i Kryetarit ZIP	Për ngjarje dhe aktivitete me rëndësi për publikun
<i>Mirëmbajtja e webfaqes komunale dhe llogarive ve në platformat sociale</i>	ZIP Zyrtarët për Teknologji të Informacionit	Gjatë gjithë kohës
<i>Reklama/Shpallje</i>	Kabineti i Kryetarit Njësia e Personelit Drejtorët e drejtorive ZIP	Sipas rastit dhe nevojës

*Takime Coffee
Klatches/World Cafe¹ të
Kryetarit dhe nënkryetarit
të komunës me
komunitetin*

Kryetari i Komunës
Nënkryetari
Kabineti i Kryetarit
ZIP

Një herë në muaj

*Ligjëratë e drejtuesve të
komunës për studentët e
universitetit*

Kryetari i komunës
Drejtorët e drejtorive
Shefat e sektorëve

Dy herë në vit

Kostoja preliminare:
19,600.00 EURO

¹ Vizita në vendet ku jetojnë/preferojnë ta kalojnë ditën pjesëtare të komunitetit

Shtojca 3. Plani i Transparencës 2021-2025

Vjosa Ahmetaj

From: Vjosa Ahmetaj
Sent: 15 February 2021 14:08
To: Anton Shala
Cc: Venera Çerkini; Xhevat Tafa; Burim Bajrami
Subject: Njoftim.....

I nderuar,

Fillimisht në emër të MPL-së ju përshëndesim dhe në të njëjtën kohë ju njoftojmë se përgjigja në ligjshmërinë e akteve të mbledhjes së Kuvendit të Komunës së Gjakovës të mbajtur me datë 28.01.2021 do vonohet për arsye procedurale. Fjala është për këto akte:

- Rregullore 01 Nr. 110/01-2737 për transparencë;
- Plani i veprimit për transparencë në Komunën e Gjakovës për periudhën 4 vjeçare 2021-2025;
- Vendim 01 Nr. 011/01- 2740 për miratimin e Strategjisë Komunale për Komunikim 2021-2023.

Andaj kërkojmë nga Ju që aktet e lartcekura të mos i publikoni në web faqen zyrtare të komunës. Me të mira dhe suksese.

Me respekt,
Vjosa Ahmetaj
Zyrtare e Lartë për Monitorim të Komunave
Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave – MPL
Tel: +381 (0) 200 35 662
+383 44 473 336
E-mail: vjosa.ahmetaj@rks-gov.net

Vjosa Ahmetaj

From: Nazmije G.Krasniqi
Sent: 19 February 2021 11:02
To: Vjosa Ahmetaj
Cc: Diellor Gashi; Xhevat Tafa; Venera Çerkini; Majlinda Shaqiri
Subject: FW:

Vjosa

Divizioni për Transparencë Komunale, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimin Administrativ Nr. 03/2020 për Transparencën në Komuna, Rregulloren Nr.01/2017 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve komunale, Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, si dhe Ligjin Nr. 06/l-081 për qasje në dokumente publike, konstaton se: Strategjinë komunale për komunikim të brendshëm dhe jashtë nga komuna e Gjakovës pavarësisht që përshkruan veprimet e komunës se si do të veprojnë në të ardhmen është në pajtueshmëri me dispozitat ligjore të transparencës

Me respekt

From: Nazmije G.Krasniqi
Sent: Tuesday, February 16, 2021 8:51 AM
To: Vjosa Ahmetaj
Subject:

Vjosa,

Divizioni për Transparencë Komunale, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimin Administrativ Nr. 03/2020 për Transparencën në Komuna, Rregulloren Nr.01/2017 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve komunale, Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, si dhe Ligjin Nr. 06/l-081 për qasje në dokumente publike, konstaton se:

I. Paragrafi 6 i nenit 4 dhe paragrafi 1 i nenit 18 të Rregullores për Transparencë të Komunës së Gjakovës, nuk janë në harmoni me njëra-tjetrën lidhur me publikimin e akteve të komunës duke përcaktuar afate të ndryshme *"tetë (8) ditë pas konfirmimit nga MAPL, përkatësisht shtatë (7) ditë pune pas konfirmimit të ligjshmërisë"*. Sipas Rregullores Nr.01/2017 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve komunale në nenin 17 paragrafi 1 është përcaktuar se *"Aktet normative të komunës hyjnë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit të aktit në ueb-faqen zyrtare të komunës, përveç nëse me vetë aktin nuk është përcaktuar ndryshe"*.

II. Paragrafi 2 pika a) i nenit 5 të Rregullores për Transparencë të Komunës së Gjakovës me të cilin përcaktohet se *"zyra për komunikim njofton publikun (2) dy ditë para mbledhjeve të komitetit për politikë dhe financa"*, është në kundërshtim me paragrafin 3 të nenit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2020 për Transparencë në Komuna, sipas të cilit *"Kryesuesi i mbledhjes së Kuvendit të Komunës ose Komitetit përkatës, nëpërmes njësisë/zyrtarit për informim, njofton publikun së paku shtatë (7) ditë pune para mbledhjeve të rregullta dhe tre (3) ditë pune para mbledhjeve të jashtëzakonshme"*.

Paragrafi 9 i Nenit 6 i Rregullores për transparencë të Komunës të Gjakovës ka përcaktuar se njoftimi i palës për çështjen e petitionit bëhet "6 (gjashtë) javë nga dita e prezantimit në kuvend" ku sipas Udhëzimit Administrativ Nr.03/2020 për transparencë në Komuna për këtë çështje në paragrafin 5 të nenit 9 ka përcaktuar se "Pas diskutimit në Kuvendin e Komunës, Kryetari i komunës ose shërbimi përkatës, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e shqyrtimit i njofton me shkrim parashtruesin e kërkesës ose petitionit".

VI. Paragrafi 9 i Nenit 7 të Rregullores për Transparencë të Komunës të Gjakovës, me të cilin përcaktohet se njoftimi për mbajtjen e takimeve publike nga organet e komunës bëhet 4 (katër) dite pune para mbajtjes së tyre" është në kundërshtim me paragrafin 4 të nenin 10 të Udhëzimit Administrativ Nr. 003/2020 për Transparencë në Komuna, ku për këtë çështje ka përcaktuar se njoftimi për takime publike duhet të bëhet "dy (2) javë para mbajtjes së takimit".

Paragrafi 3 i nenit 27 të Rregullores për transparencë të Komunës së Gjakovës ka përcaktuar se "Nëse kërkesa për qasje në dokumente publike refuzohet pala e pakënaqur me përgjigjen ka të drejtë ankese. Ankesa i dorëzohet Komisionit të Ankesave i cili duhet ta miratojë ose refuzojë Ankesën në afat prej 15 ditësh, gjë që është në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 20 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumentet Publike, i cili ka përcaktuar se e drejta e palës që në rast të refuzimit në tërësi apo pjesërisht të kërkesës për qasje në dokumentet zyrtare, mund t'i drejtohet me ankesë Agjencisë për Informim dhe Privatësi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve prej pranimit të vendimit për refuzim ose vendimit për aprovim të pjesshëm të kërkesës për qasje

Duke marrë parasysh konstatimet e përmendura më lartë, Divizioni për Transparencë jep opinion negativ lidhur me ligjshmërinë e Rregullores për Transparencë të Komunës së Gjakovës dhe planit të veprimit për transparencë, i cili është kundërshtim me Model planin e MPL-së, duke rekomanduar që Departamenti Ligjor i MAPL-së të parashtrojë kërkesë për rishqyrtim dhe harmonizim me dispozitat ligjore për transparencë në fuqi.

Ndërsa opinionin për Strategjinë komunale për komunikim do e adresojmë në ditë në vijimë

Ju fllm

From: Vjosa Ahmetaj
Sent: Wednesday, February 3, 2021 1:38 PM
To: Nazmije G.Krasniqi
Cc: Venera Çerkini; Xhevat Tafa; Diellor Gashi
Subject: FW: Aktet e KK Gjakovë

E nderuar,

Bashkangjitur gjeni Rregulloren për transparencë, Planin për transparencë dhe Strategjinë komunale për komunikim të Komunës së Gjakovës, për vlerësim të ligjshmërisë dhe ju lutem na njoftoni a janë në harmoni me legjislacionin në fuqi.

Me respekt,
Vjosa Ahmetaj

From: Shkrimorja Mapl
Sent: 02 February 2021 12:27
To: Veneša Çerkini; Xhevat Tafa; Vjosa Ahmetaj
Cc: Sibel Gutiq; Mimoza S. Morina; Aurora Kadriu
Subject: Aktet e KK Gjakovë